



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 13 nëntor 2014  
Nr. ref.: RK732/14

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KO155/14**

Parashtrues

**Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës për konfirmimin e vazhdimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. DKGJK-001-2014, të 31 gushtit 2014**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, z. Sami Kurteshi.

## **Dekreti i sfiduar**

2. Parashtruesi i kërkesës sfidon Dekretin e Presidentes së Republikës së Kosovës për konfirmimin e vazhdimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. DKGJK-001-2014, të 31 gushtit 2014 (në tekstin e mëtejme: Dekreti).

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi kërkon vlerësim të kushtetutshmërisë së Dekretit, duke pretenduar se ai është në kundërshtim me procedurën kushtetuese për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të përcaktuar në nenin 114.2 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese], në nenin 65 (11) [Kompetencat e Kuvendit] dhe në nenin 84 (19) [Kompetencat e Presidentit], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejme: Kushtetuta].
4. Për më tepër, parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) [...] të vendosë Masë të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të Dekretit të Presidentes deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Gjithashtu, parashtruesi kërkon që Gjykata të gjejë se *“[...] është në interes të publikut dhe demokracisë që tre gjyqtarët ndërkombëtarë të mos vazhdojnë të marrin pjesë në vendimmarrjen e kësaj Gjykate derisa të sigurohet kushtetutshmëria e emërimit të tyre”*.

## **Baza juridike**

5. Neni 113.2 (1) dhe neni 135.4 i Kushtetutës, nenet 27, 29 dhe 30 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

6. Më 9 tetor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 10 tetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KO155/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KO155/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
8. Më 13 tetor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga i njëjti të dorëzojë dokumente shtesë.
9. Të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Presidentes së Republikës së Kosovës dhe kërkoi nga Presidentja të dorëzojë komentet e saj, së bashku me çfarëdo dokumenti që ajo e vlerëson të nevojshëm përkitazi me kërkesën e dorëzuar. Presidentja e Republikës së Kosovës nuk ka dorëzuar asnjë koment.

10. Më 14 tetor 2014, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi dokumentet shtesë.
11. Më 4 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandim për papranueshmërinë e kërkesës.
12. Më 19 gusht 2014, Gjykata vendosi (Rasti KI124/14) të përjashtojë gjyqtarin Kadri Kryeziu nga pjesëmarrja në seancat shqyrtuese për të gjitha kërkesat e ardhshme drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ku është i përfshirë, ndër të tjerë, edhe Avokati i Popullit. Rrjedhimisht, gjyqtari Kadri Kryeziu nuk ka marrë pjesë në procedurë dhe në vendimmarrje të Gjykatës për rastin e tanishëm KO155/14.

### **Përmbledhja e fakteve**

13. Më 12 qershor 2009, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (në tekstin e mëtejme: PCN), emëroi tre gjyqtarë ndërkombëtarë në Gjykatë për një periudhë trevjeçare (Vendimi Nr. 2009/09, Vendimi Nr. 2009/10 dhe Vendimi Nr. 2009/11).
14. Më 17 korrik 2012, PCN-ja nxori Vendimin Nr. 2012/17, Vendimin Nr. 2012/18 dhe Vendimin Nr. 2012/19, për riemërimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë deri më 31 gusht 2014.
15. Më 14 prill 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës i dërgoi letër Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri (në tekstin e mëtejme: Bashkimi Evropian), *inter alia*, për të konfirmuar “emërimin e [...] gjyqtarëve ndërkombëtarë që shërbejnë në Gjykatën Kushtetuese dhe të emëruar nga PCN-ja [...]”.
16. Në të njëjtën datë, Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian iu përgjigj Presidentes së Republikës së Kosovës, duke pranuar letrën e 14 prillit 2014.
17. Më 23 prill 2014, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi me shumicë të dy të tretave Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e BE për Sundim të Ligjit në Kosovë, Nr. 04/L-274 (në tekstin e mëtejme: Ligji Nr. 04/L-274).
18. Më 31 gusht 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës nxori “*Dekretin për konfirmimin e vazhdimin të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës*”, në bazë të nenit 84.4 të Kushtetutës, të nenit 2 (Shtojca 1) të Ligjit Nr. 04/L-274 dhe, në përputhje me përmbajtjen e Letrës nr. 693, të 25 gushtit 2014, nga Shefi i Misionit EULEX Kosova, drejtuar Presidentes së Republikës së Kosovës.

### **Argumentet e paraqitura nga parashtruesi**

19. Parashtruesi pohon se Dekreti i sfiduar nuk është nxjerrë në pajtim me dispozitat e aplikueshme kushtetuese.

20. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se Dekreti i Presidentes është në kundërshtim me procedurën kushtetuese për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, sepse Presidentja e Republikës së Kosovës ua vazhdoi mandatin tre gjyqtarëve ndërkombëtarë pa marrë propozim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi).
21. Parashtruesi i kërkesës shpjegon se *“gjyqtarët e asaj Gjykate emërohen nga Presidenti ‘me propozimin e Kuvendit’, Kushtetuta, neni 114, pika 2. Ky rol i posaçëm i Kuvendit konfirmohet edhe nga dispozita të tjera kushtetuese. Neni 65, pika 11, përcakton se ‘Kuvendi i Republikës së Kosovës [...] propozon gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese’ dhe në të njëjtën mënyrë, neni 84, pika 19, përcakton se ‘Presidenti i Republikës së Kosovës emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit’.*
22. Parashtruesi i kërkesës konsideron se *“angazhimi i Kuvendit në procedurën e zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese siguron që askush nuk mund të zënë vend në gjykatën më të lartë të vendit pa u propozuar nga përfaqësuesit e drejtpërdrejtë të popullit”.*
23. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se *“vazhdimi i mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë pa propozimin e Kuvendit, nuk justifikohet nga përmbajtja e marrëveshjes ndërkombëtare e vitit 2014 midis Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian”.*
24. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se *“pyetja kryesore në këtë rast është, nëse kjo marrëveshje ndërkombëtare, bashkë me emërimet e tre gjyqtarëve ndërkombëtarë nga ana e EULEX-it, mund të justifikojë anashkalimin e Kuvendit për vazhdimin e mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë, në kundërshtim me procedurën e paraparë në Kushtetutë”.*
25. Parashtruesi i kërkesës i referohet letrës së Presidentes së Republikës së Kosovës, të 14 prillit 2014, ku *inter alia* thuhet si në vijim: *“Neni 20 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i lejon Republikës që t’i bart disa kompetenca, për çështje specifike, tek organizatat ndërkombëtare. [...] Kështu, në bazë të nenit 20 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, unë ju konfirmoj që kompetencat në vijim do t’i delegohen misionit EULEX KOSOVA- (a) të emërojë gjyqtarë, sipas neneve 65, 108, 114, respektivisht 84, të Kushtetutës, duke iu nënshtruar edhe konfirmimit të atyre emërimeve nga Presidenti, pas pëlqimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës [...]”.*
26. Parashtruesi i kërkesës argumenton se *“megjithëse nuk specifikon që do t’i delegohet EULEX-it kompetenca për të emëruar gjyqtarë, posaçërisht të Gjykatës Kushtetuese, ky paragraf [referenca e lartpërmendur në letrën] i referohet nenit 114 [i Kushtetutës] , i cili e ka titullin ‘Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese’ dhe i cili përcakton se [g]jyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit’ (neni 114.2)”.*
27. Parashtruesi i kërkesës më tej konsideron se, *“sipas nenit 20, në mënyrë që të delegohet një kompetencë tek një organizatë ndërkombëtare, ai delegim duhet të bazohet në një marrëveshje ndërkombëtare” [...]. “Në rastin e marrëveshjes*

*midis Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, letra e palës së parë, Republika e Kosovës, e përfaqësuar nga Presidentja Jahjaga, i bëri ftesë Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga baronesha Ashton, që të vazhdojë qëndrimin e EULEX-it deri në vitin 2016. Si pjesë e kësaj ftese, Presidentja Jahjaga propozoi që EULEX-i të marrë përsipër një sërë kompetencash, duke përfshirë kompetencën e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Sipas procedurës së zakonshme [...] përgjigja e baroneshës Ashton duhej të ishte një letër që i jep përgjigje palës së parë ‘duke e riprodhuar përmbajtjen e plotë të letrës origjinale dhe duke e shprehur pëlqimin mbi të’”.*

28. Sipas parashtruesit të kërkesës, kjo nuk ndodhi, por përgjigja ishte e thjeshtë dhe aty thuhej si në vijim: *“E pranoj ftesën e bërë në letrën tuaj të datës 14 prill për të vazhduar zbatimin e mandatit të EULEX-it në Kosovë, siç është cekur në Veprimin e Përbashkët 2008/124/CFSP, të miratuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian me datën 4 shkurt 2008 dhe të ndryshuar, në frymën e bashkëpunimit të ndërsjellë”.*
29. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Veprimi i Përbashkët e autorizon EULEX-in që të veprojë vetëm brenda institucioneve të krijuara në bazë të Rezolutës 1244. [...] Meqenëse Gjykata Kushtetuese nuk ka qenë institucion i krijuar sipas Rezolutës 1244, është e qartë se kompetenca për të emëruar gjyqtarët e kësaj Gjykate do ta sillte EULEX-in jashtë kornizës së Veprimit të Përbashkët. Prandaj, delegimi i kompetencës së emërimit tek EULEX-i nuk u pranua zyrtarisht nga baronesha Ashton, dhe nuk është pjesë e mirëfilltë e marrëveshjes ndërkombëtare”.*
30. Parashtruesi i kërkesës pretendon, më tej, se Presidentja e Republikës së Kosovës, në letrën e saj të 14 prillit 2014, nuk i ka deleguar EULEX-it në mënyrë të qartë dhe specifike kompetencën për propozimin e gjyqtarëve në pajtim me nenin 31, pika 1, të Konventës së Vjenës për Traktatet Ndërkombëtare. Prandaj, pretendohet se kompetenca për të propozuar gjyqtarë mbetet te Kuvendi i Republikës së Kosovës.
31. Parashtruesi i kërkesës konkludon se Gjykata ka juridiksion *ratione materiae* për të shqyrtuar këtë rast, sepse me këtë kërkesë sfidohet kushtetutshmëria e Dekretit dhe jo e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Ai argumenton se *“[...] substanca e Dekretit të Presidentes nuk është një marrëveshje ndërkombëtare; është një konfirmim i vazhdimit të mandatit të tre gjyqtarëve”.* Gjithashtu, *“një akt juridik nuk mund të shpëtohet nga juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese, thjesht duke cituar një marrëveshje ndërkombëtare. Po të ishte aq e thjeshtë, atëherë Presidentja do të mund ta citonte marrëveshjen ndërkombëtare në diskutim si bazë ligjore e të gjitha dekretëve dhe akteve të saj, pavarësisht nëse në të vërtetë kanë lidhje me të ose jo. Dhe, në këtë mënyrë, ajo do të mund të mbronte të gjitha veprimet e saj si Presidente nga shqyrtimi i kushtetutshmërisë së atyre nga Gjykata”.*

## Pranueshmëria e kërkesës

32. Sa i përket pretendimit të parashtruesit se Dekreti nr. DKGJK-001-2014, i nxjerrë nga Presidentja e Kosovës më 31 gusht 2014, është jokushtetues, Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të gjykojë lidhur me ankesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse ai i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
33. Së pari, Gjykata duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës mund të konsiderohet palë e autorizuar. Në këtë drejtim, neni 113.2 i Kushtetutës përcakton:

*“Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:*

*(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën”;*  
[...]

Gjithashtu, neni 135.4 i Kushtetutës përcakton:

*“Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute”.*

34. Në kërkesën e tanishme, Avokati i Popullit sfidon Dekretin nr. DKGJK-001-2014, të nxjerrë nga Presidentja e Republikës së Kosovës më 31 gusht 2014. Prandaj, parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe ka të drejtë ta referojë këtë çështje në Gjykatë në bazë të nenit 113.2 dhe të nenit 135.4 të Kushtetutës.
35. Sa i përket kërkesës tjetër nga neni 30 i Ligjit, sipas së cilës parashtruesi i kërkesës është dashur ta ketë dorëzuar kërkesën *“brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar”*, Gjykata konstaton se Dekreti nr. DKGJK-001-2014 është nxjerrë më 31 gusht 2014, ndërsa parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 9 tetor 2014. Parashtruesi i kërkesës, rrjedhimisht, e ka respektuar afatin për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë, të paraparë me nenin 30 të Kushtetutës (shih Rastin KO97/12).
36. Gjithashtu, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pohon se ai është duke sfiduar kushtetutshmërinë e Dekretit, por jo edhe kushtetutshmërinë e Marrëveshjes Ndërkombëtare mbi të cilin bazohet Dekreti.
37. Gjykata vëren se Presidentja e Republikës së Kosovës është e autorizuar të nxjerr dekret në bazë të nenit 84 (4) [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës, që thotë si në vijim: *“Presidenti i Republikës së Kosovës: [...] (4) nxjerr dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë [...]”*.
38. Në rastin konkret, Gjykata i referohet nenit 11 [Mjetet e shprehjes së pëlqimit për të qenë të detyruara nga dispozitat e një traktati] dhe të nenit 13 [Pëlqimi

për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati i shprehur nga një shkëmbim i instrumenteve që përbëjnë një traktat] të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve (23 maj 1969), ku thuhet si në vijim:

*“Neni 11 - Pëlqimi i një shteti për t'u kufizuar nga dispozitat e një traktati mund të shprehet me nënshkrim, shkëmbim instrumentesh që konstitudojnë një traktat, ratifikim, pranim, aprovim apo aderim, ose nga çdo mjet tjetër nëse kështu është rënë dakord”.*

dhe

*“Neni 13 - Pëlqimi i shteteve për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati të lidhur përmes shkëmbimit të instrumenteve në mes tyre quhet i dhënë në rast se: (a) instrumentet parashikojnë që shkëmbimi i tyre do të ketë atë efekt; ose (b) mund të përcaktohet ndryshe sipas rrethanave të rastit se ato shtete kanë rënë dakord që shkëmbimi i instrumenteve do të ketë atë efekt”.*

39. Gjykata vëren se Presidentja e Republikës së Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian shkëmbyen letra në pajtim me këto dispozita të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve (23 maj 1969).
40. Në dritën e kësaj, Gjykata rithekson të gjeturat e saj në Rastin KO95/13 që, në mënyrë që një marrëveshje ndërkombëtare të bëhet pjesë e sistemit juridik të Kosovës, Kuvendi duhet të miratojë ligj për ratifikim me shumicën e dy të tretave (Shih Rastin KO95/13, parashtrues i kërkesës *Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, dhe të Planit të Zbatimit për këtë Marrëveshje, Aktgjykim i 9 shtatorit 2013). Në rastin e tanishëm, Kuvendi miratoi një ligj të tillë më 23 prill 2014 (shih Ligjin nr. 04/l-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë).
41. Gjykata thekson se Dekreti i sfiduar nuk krijon obligime të reja. Në të vërtetë, Dekreti, i nxjerrë nga Presidentja, është në linjë me obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, të inkorporuara në Marrëveshjen Ndërkombëtare, të lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe të ratifikuar nga Kuvendi. Në këtë kontekst, ratifikimi i Marrëveshjes Ndërkombëtare nga Kuvendi formalizon pëlqimin e shtetit për t'u detyruar nga Marrëveshja në raport me palën tjetër dhe Dekreti i Presidentes së Kosovës shërben si një akt implementues i atyre dispozitave të Marrëveshjes Ndërkombëtare që nuk janë të vetëzëkuteshme.
42. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se përmbajtja e Dekretit është *“Për konfirmimin e vazhdimin të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës”*. Pra, Dekreti ka të bëjë me vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë, tashmë të emëruar, që shërbejnë në

Gjykatë që nga viti 2009, dhe që ishin riemëruar deri më 31 gusht 2014 nga PCN-ja, më 17 korrik 2012.

43. Gjykata thekson se neni 84 (19) [Kompetencat e Kuvendit], i Kushtetutës, i cili thotë, si në vijim: *“Presidenti i Republikës së Kosovës: [...] emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit [...]”*, ka të bëjë me emërimin e gjyqtarëve të rinj kosovarë në Gjykatë, ndërsa Dekreti ka të bëjë me vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve të tanishëm ndërkombëtarë. Kësisoj, neni 84 (19) i Kushtetutës nuk është i aplikueshëm në rastin e tanishëm.
44. Përveç kësaj, Gjykata rikujton se për emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë ishte ndjekur një procedurë tjetër dhe ishin aplikuar kërkesa të tjera nga ato për emërimin e gjyqtarëve kosovarë. Mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë dallon gjithashtu dhe është i përcaktuar me kontratë të ofruar nga aktorë ndërkombëtarë.
45. Në fund, Gjykata vëren se argumentet e parashtruesit të kërkesës kryesisht ndërlidhen me përmbajtjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare të lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian nëpërmjet këmbimit të letrave, e ratifikuar nga Kuvendi më 23 prill 2014, edhe pse parashtruesi pohon se ai sfidon vetëm kushtetutshmërinë e Dekretit. Prandaj, parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij dhe nuk ka provuar se Dekreti është jokushtetues.
46. Po ashtu, siç e thekson me të drejtë edhe vetë parashtruesi i kërkesës, Gjykata nuk ka juridiksion *ratione materiae* për të trajtuar çështjen nëse marrëveshjet ndërkombëtare janë në përputhje me Kushtetutën (Shih Rastin KO95/13, parashtrues i kërkesës *Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, dhe të Planit të Zbatimit për këtë Marrëveshje, Aktgjykim i 9 shtatorit 2013).
47. Prandaj, sa i përket procedurës së ndjekur nga Presidentja, Gjykata konkludon se Dekreti është në pajtueshmëri me Kushtetutën.
48. Rrjedhimisht, Gjykata e refuzon kërkesën si qartazi të pabazuar, në mbështetje të paragrafit (1) c) dhe të paragrafit (2) të rregullit 36 të Rregullores së punës.

### **Kërkesa për Masë të përkohshme**

49. Sa i përket kërkesës për Masë të përkohshme, Gjykata vëren se parashtruesi kërkon nga Gjykata të pezullojë Dekretin e Presidentes dhe të mos lejojë tre gjyqtarët ndërkombëtarë të vazhdojnë *“të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes deri sa të sigurohet kushtetutshmëria e emërimit të tyre”*.
50. Neni 27 i Ligjit dhe, në veçanti, rregulli 54 (1) i Rregullores së punës, parashohin: *“Në qfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e Masës së përkohshme”*.



51. Gjykata më tej i referohet rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, që parasheh:

*(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*

*(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; dhe*

*(c) Masa e përkohshme është me interes publik.*

*Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës.*

52. Megjithatë, pasi kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar dhe, për pasojë e papranueshme, Gjykata konkludon se kërkesa për Masë të përkohshme nuk mund të jetë më objekt i shqyrtimit dhe, për pasojë, duhet të refuzohet.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 29 të Ligjit dhe në mbështetje të paragrafit (1) c) e të paragrafit (2) të rregullit 36 të Rregullores së punës, më 13 nëntor 2014, njëzëri

### **VENDOS**


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për Masë të Përkohshme;
- III. T'IA KUMTOJË këtë vendim parashtruesit të kërkesës dhe Presidentes së Republikës së Kosovës;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

  
Arta Rama-Hajrizi



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

  
Prof. dr. Enver Hasani